



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E QYTETIT KORÇË

Vendim

Nr. 150 Datë 22.12.2021

Për

Disa ndryshime në vendimin Nr.136, dt 25.11.2021 të Këshillit të Bashkisë Korçë

Për

Miratimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2021-2022 në institucionet arsimore publike

Mbështetur ne Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.666 dt. 10.10.2019 për “Kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, për vitin shkollor 2021-2022, si dhe në zbatim të Ligjit 139/2015 dt. 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

Këshilli i Bashkisë së qytetit Korçë, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Për “Disa ndryshime në vendimin Nr.136, dt 25.11.2021 të Këshillit të Bashkisë Korçë”, Për “Miratimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2021-2022 në institucionet arsimore publike”

Vendosi

1. Tu miratojë bursa nxënësve të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2021-2022, pasi i plotësojnë të gjitha kriteret për përfitimin e bursës (kuotës financiare/ushqimore) sipas tabelës së poshtëshënuar për institucioneve arsimore publike të Bashkisë Korçë dhe listave përkatëse bashkëngjitur këtij vendimi.

Nr.	Institucioni arsimor	Nr. i nx. që përfitojnë bursë	Nr. i nx. që përfitojnë veshmbathje	Nr. i nx. që përfitojnë kuotë ushqimore
1	Shk. 9-vjeçare Stavri Themeli	4	4	-
2	Shk. 9-vjeçare Naum Veqilharxhi	39	39	-
3	Shk. 9-vjeçare Asdreni	53	53	-
4	Shk. 9-vjeçare Ismail Qemali	33	33	-
5	Shk. 9-vjeçare Demokracia	19	19	-
6	Shk. 9-vjeçare Naim Frashëri	-	-	-
7	Shk. 9-vjeçare Sevasti Qiriazhi	12	12	-
8	Shk. 9-vjeçare Nuçi Naçi	22	22	-
9	Shk. 9-vjeçare e Muzikës	20	20	-
10	Shk. 9-vjeçare Pandeli Cale	4	4	-
11	Shk. 9-vjeçare Mësonjëtores	4	4	-
12	Shk. 9-vjeçare Sotir Gurra	9	9	-
	Gjithsej	219	219	-
1	Gjimnazi "Raqi Qirinxhi" Korçë	19	-	-
2	Gjimnazi "Themistokli Gërmenji" Korçë	26	-	1
3	Gjimnazi "Ymer Dishnica" Korçë	17	-	1
4	Gjimnazi Gjuhësor "Faik Konica" Korçë	13	-	-
5	Shk. e Mesme Artistike "T.T.Koço" Korçë	6	-	-
	Gjithsej	81	-	2
1	Shk. e Mesme e Agr. "Irakli Tërova" Korçë	175	38	8
2	Shk. e Mesme TIK "Fan S. Noli" Korçë	41	15	2
3	Shk. e Mesme Profesoionale e Ndërtimit Korçë	113	37	5
4	Shk. e Mesme Tek. Prof. "Demir Progri" Korçë	36	10	9
5	Shk. e Mesme Teknologjike "Isuf Gjata" Korçë	79	54	4
	Gjithsej	444	154	28
	Totali	744	373	30

- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen N.SH.M.A.Ç dhe drejtoritë e shkollave 9-vjeçare, të mesme të përgjithshme dhe profesionale.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT TË BASHKISË

Erion Nexhipi

